



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur- ....., kryetar i Komunës ....., në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi i parashtruar nga parashtrues i njohur – ....., kryetar i Komunës ....., deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të së cilit është formuar lëndë me numër 12-5792/1 nga viti 26.12.2019, tek i cili theksohet për dyshime për veprime të korruptuara të paligjshme nga individ me pozitë zyrtare dhe autoritet të cilin me veprimin e tij e ka dëmtuar buxhetin shtetëror, **REFUZOHE**T.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit pas kontrollit në përmbajtje të denoncimit konstaton se nuk ka elemente për veprim kompetent të mëtutjeshëm për lëndën, ose vepron organ tjetër kompetent shtetëror.

Lënda me numër 12-5792/1 nga viti 26.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e vendimmarrjes.

### Sqarim

Lënda me numër 12-5792/1 nga viti 26.12.2019 e formuar në bazë të denoncimit nga parashtruesi ....., kryetar i Komunës .....

Në denoncim theksohet për dyshime për veprime të korruptuara të paligjshme nga ana e personit me pozitë zyrtare dhe autoritet i cili me veprimin e tij e ka dëmtuar buxhetin shtetëror. Në përputhje me akuzat nga denoncimi, kryetari i mëparshëm i Komunës ....., ....., e ka mundësuar që të zbatohet procedura për furnizim publik të sendeve ndërtimore për ndërtim të ndërtesës administrative në Komunën .....ku komuna paraqitet si investitor, ka lidhur marrëveshje për ndërtim të objektit dhe e ka futur në punë kontraktuesin pa aprovim për ndërtim. Gjithashtu, përmendet që edhe pse objekti administrativ ekzistues ka qenë në procedurë për riparim, në vend të këtij vendimi më ekonomik, kryetari i komunës ka vendosur për investim më shumë se 17 milion dinarë në ndërtim pa leje, me çka i ka keqpërdorur mjetet e shtetit dhe ka shkaktuar dëmtim të Komunës .....për shkak se ndërtesa e ndërtuar pa leje nuk i plotëson kushtet nga Ligji për veprim me objektet e ndërtuara pa leje dhe si i tillë është dashur që të shembet. Në përputhje me akuzat dhe bashkëngjitjet tek

denoncimi, për këtë rast është paraqitur denoncim penal deri tek Prokuroria Themelore Publike ..... në muajin dhjetor të vitit 2019.

Në bazë të të gjitha rrethanave të rastit të lëndës së parashtruar, ndërsa duke e pasur parasysh që për rastin e denoncuar është parashtruar denoncim penal deri tek Prokuroria Themelore Publike ....., komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, ka vlerësuar se bëhet fjalë për denoncim i cili nuk përmban elemente për veprim kompetent në përputhje me nenin 27 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për shkak të veprimit të organit tjetër kompetent shtetëror.

Duke e pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19), vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pas mbarimit të seancës së KSHPK:

Punoi: mr B.K.SH., këshilltarë

Miratoi: S.P.D., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР PËR  
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT  
Kryetar: Biljana Ivanovska